



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 26/05/2022 Ref.: G76/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 99-të, të mbajtur më 13.05.2022, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. Sociologji, BA, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Sociologji, BA, 180 ECTS Ri-akreditim	Dr. Agim Hyseni Dr. Fadil Maloku Dr. Linda Gusia

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC

AKA ka organizuar tri vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.


Vizitat janë organizuar më 21.03.2022, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Pavo Barisic.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, bazuar në fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Sociologji, BA, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4) standarde dhe tri (3) substancialisht.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 99 të mbajtur më 13.05.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatit prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Nazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit Filozofik;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.